



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

311/19
24.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit AK: Komuna e Podujevës	Kopje	Paneli Shqyrtues – OSHP: Nr. 311/19
	OE ankues: N.P.SH. "Starlin" – Podujevë		
Prej:	Sahit Beqiri – Ekspert shqyrtues i prokurimit <i>Beqiri</i>		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 311/19 të parashtruar nga OE: N.P.SH. "Starlin" – Podujevë		
Datë	24.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën me datën: **13.06.2019** me Nr. 311/19 të parashtruar nga OE: **N.P.SH. "Starlin" – Podujevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e Dëshmorëve në Ballofë"**, me nr. prokurimi: **615-19-1416-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna e Podujevës**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Komuna e Podujevës.*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – N.P.SH. "Starlin" – Podujevë*



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	14.06.2019	17.06.2019	24.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të ekspertit	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 13.06.2019 OE: N.P.SH. "Starlin" – Podujevë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e Dëshmorëve në Ballofë", me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Podujevës.

Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nuk është nxjerr ndonjë njoftim/vendim nga OSHP-ja.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

N.111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: N.P.SH. "Starlin" – Podujevë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues: N.P.SH. "Starlin" – Podujevë, janë:

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 108/A i LPP-së

Rregullat për paraqitje të kerkese për rishqyrtim pran Autoriteteve Kontraktues, parashtim të ankesave prane OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Te nderuar, autoriteti kontraktues ne këtë aktivitet të prokurimit na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt. 27.05.2019, dhe ku na ka informuar se kontrata i është dhënë OE: "granit Hyseni B.I." me çmim prej 49,336.12 €.

Ne, në hapje të tenderit kemi çmimin me të lire se OE i rekomanduar për kontrate duke ofruar çmimin prej 49,012.51 €, ndërsa pastaj jemi njoftuar se kemi çmimin me të lartë se OE i rekomanduar për kontrate dhe nuk e dimë se si ka ndodhur ky ndryshim në çmime. Edhe pse nëse do të kishte ndonjë gabim në përllogaritje të çmimeve, autoriteti kontraktues sipas nenit 59.3 të LPP-se është i obliguar të njoftoj operatorin ekonomik me ndryshimet e tilla. Ndërsa po ashtu nuk kemi asnjë informate se është përdorur neni 41.8.9.10 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP).

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate "Granit Hyseni B.I." është i papërgjegjshëm sepse nuk ka plotësuar kërkesën e nenit 9.1 * 9.2 të FDT-se, në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, duke mos ofruar asnjë dëshmi që ka në pronësi ndonjë mjet makineri dhe njëkohësisht nuk ka asnjë dëshmi që ka marrëveshje me ndonjë kompani tjetër për shfrytëzimin e pajisjeve.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.P.Sh. "Starlin" – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e dëshmorëve në Ballofë", me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Podujevës.

S.B

I njëjti operator ekonomik ka ofruar si dëshmi një libeze për një kamionët me korp dy dyer ne emër te OE Risamont te regjistruar me dt. 15.05.2017, Një libeze për një kamion me kran dy dyer ne emër te NP Risamont te regjistruar me dt. 31.01.2018, Një libeze për një kampionet dubelkabin katër dyer ne emër te NP Rismont e regjistruar me dt. 06.04.2017, një DUD doganor për ekskavator i përdorur me luge ne emër te ELKO Group Shpk, pastaj fatura ne lidhje me këtë ekskavatorë ku figuron se e ka blere NP Rismont e dt. 16.07.2017, Një marrëveshje për shfrytëzimin e makinerisë ndërmjet NP Rismont dhe personit fizik Ramiz Sadiku për një ekskavatorë dhe një deklaratë e bere nga personi Ramiz Sadiku, tek noteri ne prani te dëshmitareve se është pronar i një traktori dhe se i kane humbur dokumentet dhe janë ofruar disa fotografi te ndonjë pajisje.

OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar një liste te mjeteve te punës, ndërsa ne fund te listës shkruan se këto mjete te pika 1, 2, 3, 4 janë te NP Risamont me te cilin kemi marrëveshje për huazim te mjeteve me qira për projektet e vitit 2019, por i njëjti operator ekonomik, te bashkangjitur me dosje te tenderit nuk ka asnjë marrëveshje me asnjë kompani e as person fizik.

Pra OE i rekomanduar për kontrate nuk ka asnjë pajisje personale e nuk ka asnjë pajisje te kontraktuar me qira e as ndonjë dëshmi tjetër qe e plotëson kërkesën e AK-se. Përveç qe nuk ka asnjë pajisje ne pronësi e as marrëveshje me dike tjetër edhe libezat qe i ka ofrua për disa pajisje, nuk kane regjistrim valid.

Gjithashtu edhe për menaxherin e projektit operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar dëshmi se ka përvojë pune, dy vite pas diplomimit. Nuk ka asnjë referencë për përvojë pune madje as ne CV e tij nuk shënon qarte se ku dhe sa ka punuar.

Ne vendimin e AK-se te dt. 11.06.2019 për refuzim te kërkesë për rishqyrtim nuk është nënshkruar dhe vulosur . Lidhur me këtë arsytim, ju sqarojmë se ne e kemi përpiluar kërkesën për rishqyrtim, ku janë te gjitha te dhënat e kompanisë tone, emri i operatorit ekonomik, emri i përfaqësuesit tone, numri i telefonit, emali adresa, vendi, adresa etj. Këtë kërkesë e kemi bashkangjitur me attachment dhe e kemi dërguar ne adresën zyrtare te zyrës se prokurimit te Komunës se Podujevës.

Kërkesa për rishqyrtim është valide sepse është e përpiluar nga ne, është dërguar nga adresa zyrtare e kompanisë tone, është e dërguar ne adresën zyrtare te prokurimit te Komunës etj etj. ... Mirëpo nëse do te kishte ndonjë mangësi kërkesa për rishqyrtim atëherë është obligim i AK-se te kërkoj nga ne qe te plotësojmë dokumente eventuale te munguara apo nëse do te kishte ndonjë dileme apo paqartësi ka mundur te kërkoj sqarime shtesë nga ne.

Gjithashtu ju sqarojmë se edhe tek neni 108/A i LPP-se, e as tek neni 5 i Rregullave për paraqitje te kërkesa për rishqyrtim pran AK, parashtrim te ankesave pran OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, nuk shkruan se ne formën elektronike duhet te nënshkruhet kërkesa për rishqyrtim.

Si arsytim i tret është përdorur se nuk e kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim ne E-prokurim.

Lidhur me kete arsytim, ju sqarojmë se neni 108/A paragrafi 3 i LPP-se shkruan qarte: *"Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

Pra ne kemi vepruar konforme kësaj dispozite te LPP-se dhe kemi dërguar me e-mail. Përderisa është lënë mundësia te dërgohet me e-mail kërkesa për rishqyrtim, na jep te kuptojmë se kjo ka mundur te behet edhe pa attachment dhe pa e përdorur edhe formularin standard te kërkesës për rishqyrtim dhe natyrisht te mos nënshkruhet sepse vete komunikimi m e-mail apo komunikimi elektronike është forme zyrtare e komunikimit dhe çdo shkrese duhet te pranohet si e vlefshme nëse behet me e-mail.

Si arsytim i katërt është se nuk i kemi bashkangjitur listën e dokumenteve dhe se janë shënuar disa te dhëna dhe data tjera qe nuk kane te bëjnë me këtë aktivitet te prokurimit. Sa i përket arsyes me nr. 1, 2 dhe 4 te dhënat ne vendimin e AK-se, ju sqarojmë se neni 108/A paragrafi 5 i LPP-se shkruan qarte: *Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.*

Tek te dhënat mbi aktivitetin e prokurimit janë te shënuara te dhënat e sakta, si data e njoftimit për kontrate, letrës standarde për tenderues te pasuksesshëm, data e hapjes se ofertave etj etj ... Autoriteti Kontraktues ne këtë rast ka përdorur- ka marr parasysh lëshime teknike, jo esenciale për te na bere te pavlefshëm kërkesën tone për rishqyrtim.

S.B

Pra nëse autoriteti do të konsideronte se nuk është e plotë kërkesa për rishqyrtim, është dashur të veprojë menjëherë konform kësaj dispozite të LPP-se e jo të pres 11 dite për të nxjerrë vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Shtrohet pyetja pse është parashikuar në paragrafin 5 të nenit 108/A të LPP-se, dispozita në fjalë. Natyrisht kuptohet që është parashikuar sepse operatorët ekonomik mund të gabojnë dhe të sjellin informata apo dokumente jo të plota apo të pamjaftueshme dhe me këtë rast AK-ja obligohet të kërkojë plotësimin e informacionit apo dokumenteve. Autoriteti kontraktues nuk na ka kërkuar ndonjë dokument shtesë apo ndonjë informacion se na mungon ndonjë element apo ndonjë dëshmi relevante.

Si arsyetim i **peste** është shënuar se nuk e kemi bashkangjitur kërkesën për qasje në dokumente. Po ashtu edhe ky arsyetim nuk është i bazuar në asnjë bazë ligjore por është shtuar si arsyetim vetëm për të bërë me shumë pika. AK-ja me dt. 03.06.2019 ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit që normalisht e ka pranuar si valide kërkesën për rishqyrtim, sepse edhe në hyrje të vendimit për pezullim shkruan se duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim.

Kërkesa për rishqyrtim është dashur të shqyrtohet sepse i përmbana të gjitha elementet edhe pse mund të ketë ndonjë lëshim të parëndësishëm teknik, mirëpo autoriteti kontraktues duke e parë të vërtetën se OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm ka dashur që me këto arsyeime të pabaza të na eliminojë neve nga kjo garë.

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-se njëkohësisht ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se, duke e shpërblyer me kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, kurse paragrafi 4 i nenit 59 të LPP-se parasheh qartë: *Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.* ndërsa oferta e këtij operatori ekonomik nuk është në harmoni dhe përputhshmëri me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka marrë parasysh edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të ulët, ashtu siç e parasheh edhe neni 60.1.1 i LPP-se, sepse si operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim me të ulët jemi në dhe është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi. Gjithashtu nuk e ka respektuar edhe procedurat e nenit 108/A të LPP-se për të shqyrtuar kërkesën tone për rishqyrtim.

Duke u bazuar në dheshmit dhe faktet që u ceken më lart, kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë:

VENDIM

APROVHET, ankesa e OE NTSH "Lypeteni" si e bazuar dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucione tjera kompetente.

Pretendimet ankimore tek dispozitat e shkelura nga AK ligjore janë të njëjta me kërkesën për rishqyrtim përveç që është shtuar edhe neni 108/A (e i cili në kërkesën për rishqyrtim nuk ka mundur të bëhet) pranë AK – Komuna e Podujevës.

S.B

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	25.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Punë
Vlera e parashikuar e kontratës:.....	60,000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës (N.52).....	Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	15.04.2019
Data e hapjes së ofertave.....	15.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	16.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.....	27.05.2019
Data e njoftimit mbi Vendimin e AK - B58	27.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	31.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	11.06.2019

Kriteret për vlerësim:

III.2 KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

Kërkesat e përshtatshmërisë:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesat:

OE duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të LPPK-së

Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës

Vërtetimi nga Gjykata kompetente

Evidencat: Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë:

Një deklaratë në betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në aneksin 2

Një vërtetim nga ATK në vendin e themelimit të OE se OE në fjalë nuk është me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Vlenë për OE fitues

Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se OE nuk është i falimentuar apo likuiduar. Vlenë për OE fitues

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Përshtatshmëria profesionale:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesat:

Regjistrimi i OE në regjistrin profesional komercial apo regjistrin e ndërmarrjeve

Certifikata e numrit fiskal

Certifikata për regjistrim në TVSh

Evidencat:

Certifikata e biznesit (kopje)

Certifikata e numrit fiskal (kopje)

Certifikata e TVSH (kopje)

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Kërkesat: OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit ka qenë jo më pak se 120,000.00 euro.	Evidencat: Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare që dëshmon transaksionet financiare për tre vitet e fundit
---	---

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Kërkesat: Projektet e realizuara (të natyrës së ngjajshme) në tre vitet e fundit e vërtetuar nga OE, minimumi në vlerë 90,000.00euro Në rast të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit OE duhet të ofroj dëshmi se mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për realizimin e këtij projekti, minimumi 10 puntorë a) një menaxher i projektit të jetë ingjiner i diplomuar ose master i ndërtimtarisë, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt	Evidencat: Lista e projekteve të realizuara gjatë periudhës trevjeçare në të cilat specifikohen të gjitha projektet e realizuara në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe vendin e kryerjes së punimeve, bashkangjitur referenca ose certifikatë ose raporte të pranimit Lista me numër të puntorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e noterizuar, cv-ja, kontrata, nëse nuk është në listën e puntorëve kërkohe marrveshja për angazhim në këtë projekt Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër
---	---

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vlera e parashikuar	Vërejtje & E-prokurimi
1.	"Tribun" Shpk	Prishtinë	50843.84 €	60,000.00 €	JO / E-prokurim elektronik
2.	N.P. "Konaku"	Prishtinë	50343.95 €		JO / E-prokurim elektronik
3.	"Detari" Shpk	Prishtinë	49969.68 €		JO / E-prokurim elektronik
4.	"Isars" Shpk	Prishtinë	49882.88 €		JO / E-prokurim elektronik
5.	N.N.T. "Brezi Kufitar"	Podujevë	57687.32 €		JO / E-prokurim elektronik
6.	N.P.SH. "Starlin"	Podujevë	49012.51 €		JO / E-prokurim elektronik
7.	"Kompania Prishtina" Shpk	Prishtinë	51888.00 €		JO / E-prokurim elektronik
8.	"Arad 94" Shpk	Prishtinë	57959.43 €		JO / E-prokurim elektronik
9.	"Intering Construction" Shpk	F. Kosovë	59610.39 €		JO / E-prokurim elektronik
10.	"Konstruktori Ing.1969"	Prishtinë	53385.87 €		JO / E-prokurim elektronik
11.	NNP "Ndertimtari- Maxhunaj"	Vushtrri	54452.00 €		JO / E-prokurim elektronik
12.	"Granit S. Hyseni B.I. "	Podujeve	49336.12 €		JO / E-prokurim elektronik

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.P.Sh. "Starlin" – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e dëshmoreve në Ballofë", me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Podujevës.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Hanushe Gjata – Latifi – Kryetar i komisionit (//////)
- Musli Kutleshi – Anëtar i komisionit (//////)
- Mehmet Kastrati – Anëtar i komisionit (//////)

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni Ri-vlerësues ka konstatuar:

DEKLARATË:

Komisioni në përbërje të plotë prej tre anëtareve pas vlerësimit dhe ekzaminimit të të gjithë dosjeve të tenderëve konstatoi se OE “Granti S. Hyseni B.I. i plotëson kriteret e kërkuara në DT nga AK dhe si çmimi më i lirë komisioni rekomandon që ky OE të shpërblehet me kontratë.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM	VENDI	ÇMIMI € (Euro)
“Granit S. Hyseni B.I. “	Podujevë	49,336.12 €

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se (10) OE ofertues janë të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për kontratë OE: “Granit S. Hyseni B.I. “ - Podujevë, me çmim prej: 49,336.12 €

Menaxheri i prokurimit aprovon/pajtohet me raportin e komisionit të vlerësimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.P.SH. “Starlin” – Podujevë.

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt. 27.005.2019 dhe na ka informuar se kontrata i është dhënë OE “Graniti Hyseni B.I.” me çmim prej: 49,336.12 012 €

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit (në këtë aktivitet të prokurimit), AK nuk e ka respektuar në plotësi nenin 7 paragrafi 2, të LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik” si dhe neni 59 par. 3 të LPP-se, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tender të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Autoriteti kontraktues menjëherë do të dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla. AK gjatë ekzaminimit të tenderëve ka konstatuar se OE ankues ka bërë gabime aritmetike tek paramasa dhe parallogari (përshkrimi i çmimeve) në Excel tek poz. nr. 68 (Punimet e zdrukthëtarisë) si: $(2 \times 600 = 600)$ duhet të jetë: $2 \times 600 = 1200$ € si dhe tek poz. nr. 228 (Punimet e Kaldajës) si: $(2 \times 100 = 100)$ duhet të jetë $2 \times 100 = 200$ € që në total është: 700 € (gabim teknik në çmimin total të lexuar në proces-verbalin hapjes dhe formularin e tenderit) dhe në përqindja është: 1.68% që do të thotë është me pak se 2%. Duke marr për bazë këtë gabim tek OE ankues AK ka qenë i obliguar të njoftoj të gjithë OE pjesëmarrës dhe OE përmes Letrës standarde për Llogaritje të gabuar, mirëpo AK nuk ka njoftuar fare OE ankues dhe tenderuesit tjerë (nuk kam hasur në asnjë shkresë letrë standarde për sqarimin e tenderit). AK pavarësisht se nuk e kalon 2% ka qenë i obliguar të njoftoj dhe të kërkoj se a pajtohet me llogaritjen e gabuar. Prandaj, duke pas parasysh nenet e lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë janë të qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikas, me transparent dhe me të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Andaj, AK – Qendra e Studenteve, nuk ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE: N.P.Sh. “Starlin” – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e dëshmoreve në Ballofë”, me nr. prokurimi: 615-19-1416-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Komuna e Podujevës.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, konkretisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën 9.1 & 9.2 të FDT-së në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, duke mos ofruar asnjë dëshmi që ka në pronësi ndonjë mjet makineri dhe njëkohësisht nuk ka asnjë dëshmi që ka marrëveshje me ndonjë kompani tjetër për shfrytëzimin e pajisjeve

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur pran AK-se dokumente si ne vijim: Një liste të mjeteve (makinerisë dhe tjera) e nënshkruar vetëm nga OE "Graniti S. Hyseni B.I." po citoj: "P.S: Makinaria tek pikat 1,2,3 dhe 4 i takojnë kompanisë **Risamont SHPK** me të cilën kemi marrëveshje për huazimin e mjeteve me qira për projektet në vitin 2019" me datë 15.04.2019, (mirëpo mungon marrëveshja e nënshkruar mes OE për huazim të mjeteve).

Lista e makinerisë pika 1, 2, 3, dh 4 janë:

1. Kamion me dy dyer;	Nr. regjistrimi: 01-146-LD;	Sasia: 1 copë	Data e regjistrimit: 30.01.2019
2. Kamionet me korp 2 dyer	Nr. regjistrimi: 01-826-JQ;	Sasia: 1 copë	Data e regjistrimit: 15.05.2017
3. Mini bager 5 ton	/////	Sasia: 1 copë	////
4. Autoshpordë 15 m	Nr. regjistrimi: 01-815-BG	Sasia: 1 copë	/////

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka bashkangjitur një Marrëveshje për shfrytëzim të makinerisë në mes të OE NT Risamont dhe Ramiz Sadiku me numër ID: 1005871413 me datë 01.01.2017 si dhe një deklaratë nën betim nga Ramiz Sadiku se posedon një traktor prodhim KAGE; Tipi – 580 K; Nr. shasis EXWLDGSTOT; Ngjyre e kafet me të verdhe; Me numër të serisë: JH0012114; Peshë 8000 KG, tek noteri Sinan Visoka - me datë 11.01.2015 si dhe disa fotografi. Si dhe duke marrë për bazë se AK në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, po citoj: *Kërkesa* "Mjetet e punës të domosdoshme për realizimin e punimeve në këtë projekt; Dëshmia: Lista e pajisjeve - mjeteve të punës që OE duhet të ketë ose të kontraktuara (me qira) të dëshmohet me kopje të librezave apo ndonjë dëshmi tjetër".

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i rivlerësimit ka mundur të kërkojë sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 39 të RrUOPP-së. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur rregullat e LPP-së, konkretisht lidhur me menaxherin e projektit se nuk ka ofruar dëshmi se ka përvojë pune, dy vite pas diplomimit, nuk asnjë referencë për përvojën e punës, madje as në CV e tij nuk shënon qartë se ku dhe sa ka punuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka bashkangjitur me vendim ka caktuar menaxher të projekti z. Fatmir Ternava – Inxh. i ndërtimtarisë Konstruktiv i cili ka diplomuar me datë 04.01.2012 (Diploma e notrizaruar) dhe CV e tij shkruan se ka përvojë 19 vite dhe ka realizuar disa projekte. Mirëpo duke pas parasysh nenin 9.1 & 9.2 të FDT-se, po citoj: *Kërkesa* "a) një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i ndërtimtarisë, përvoja e punës 2 vite pas diplomimit; Dëshmia: Për stafin profesional (inxhinierë) - kopja e diplomës e notrizaruar, cv-ja, kontrata, nëse nuk është në listën e punëtorëve kërkohet marrëveshja për angazhim në këtë projekt".

Gjithashtu, **eksperti shqyrtues profesional sqaron** si ne vijim: Kërkesat për sqarime shtesë në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-se, është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave të kërkojë sqarime me shkrim nga tenderuesit mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tyre, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve apo të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda afatit ligjorë të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla të bëhen në përputhje të plote me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë pretendim mendon se operatori ekonomik, i sipërpërmendur nga i gjithë ky sqarim plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues në lidhje me kërkesën teknik dhe profesionale të FDT-se – stafi profesional, andaj duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 108/A te LPP-së dhe Rregullat për paraqitje te kërkesë për rishqyrtim pran autoriteteve kontraktuese.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne fakte te prezantuar ne dokumentacionin qe kam pranuar ne shqyrtim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit (ne këtë aktivitet te prokurimit), AK nuk e ka respektuar neni 108/A par. 3 dhe 5 te LPP-se, po citoj: “3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, “5. Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.” si dhe nenin 6 par. 6.2 te Rregullores për paraqitje te kërkesë për rishqyrtim pran AK, po citoj: “Nëse mungon ndonjë nga elementet e përmendura nën nenin 5.1 te këtyre rregullave, Autoriteti Kontraktues, **respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit**, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë”. AK – ZPP në vendimin me date 11.06.2019 (kërkesa për rishqyrtim nga OE ankues me date 31.05.2019), pasi tek arsyetimi ZPP, jap një arsyetim ne kundërshtim me nenet si më lartë. Prandaj, duke pas parasysh nenet e lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë janë të qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, në ankese e OE: **N.P.SH. "Starlin"**– Podujevë, për tenderin e AK: **Komuna e Podujevës**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndërtimi i Ambulancës në lagjen e Dëshmorëve në Ballofc**", me nr. prokurimi: **615-19-1416-5-2-1**, lidhur me njoftimin për kontratë, rekomandon që ankese e OE ankues të **aprovohet si pjesërisht të bazuara**, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë autoritetin kontraktues – Panelin Shqyrtues, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ky aktivitet i prokurimit te kthehet në **Rivlerësim**.